



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK
VENDIM**

Nr. 25 datë 29.4.2024

**PËR MIRATIMIN E PLANIT “PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E
ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR NË BASHKINË SHKODËR PËR
VITIN 2024”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 29.4.2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur nënin 27 pika 5, e ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; **neni 30** pika 4, germa ‘b’/ ‘c’ e **ligji nr. 57/2020 “Për pyjet”,** Ligjit nr 45/2019 “ Për mbrojtjen civile”; Ligjit Nr. 9693, datë 19.3.2007: “Për fondin kullor” të ndryshuar; VKM nr 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat per parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”. VKM nr 433 datë 08.06.2016 “ Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike , sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar; VKM nr 59, date 26.01.2022 “ Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe sipërfaqes së ekosistemeve natyrore park kombëtar (kategoriaII) të zonave të mbrojtura “; VKM nr 60, datë 26.01.2022 “ Shpallja e ekosistemeve natyrore rezervat natyror i menaxhur /Park Natyror (kategoria IV) , si dhe miratimin e ndryshimit të statusit e të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore, që i përkasin kësaj kategorie” i ndryshuar, si dhe referuar relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër;

V E N D O S I:

1. Të miratojë planin “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullor në Bashkinë Shkodër për vitin 2024”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 35 vota

Vota Pro 35

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 7.5.2024

